



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 309, Datë 30.10.2023

MBI

**PEZULLIMIN E VENDIMARRJES SË BORDIT TË ERE-S NË LIDHJE ME
APLIKIMIN E SHOQËRISË “ECO-ELB” SH.A. PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 14, pika 10 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 30.10.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 137/19 prot., datë 24.10.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “ECO-ELB” sh.a. në veprimtarinë e e prodhimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “ECO-ELB” sh.a. më datë 27.09.2023 ka paraqitur në ERE aplikimin për rinovimin e licencës për prodhimin e energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 93, datë 28.04.2022 të rinovuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 142, datë 24.04.2023. Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 290, datë 09.10.2023 vendosi të fillojë procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë “ECO-ELB” sh.a. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Centrali TEC (përpunimi i mbetjeve urbane), Qarku Elbasan, me kapacitet të instaluar 2850 kW.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 10.10.2023 dhe 11.10.2023) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 19.10.2023), nuk rezultoi të ketë të tilla.
- Me shkresën nr. 137/16 prot., datë 13.10.2023, ERE iu drejtua shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës.
- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit dhe ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar nga “Rregullorja për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin,

njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, dhe nuk rezulton debitore përsa i përket pagesave të rregullimit.

- Në kuadër të vendimmarrjes së bordit të ERE-s mbi këtë aplikim, duke qenë se shoqëria “ECO-ELB” sh.a. ka një kontratë të vlefshme me Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AAPSK) për përdorimin e impiantit të incenerimit për prodhimin e energjisë elektrike deri më datë 27.03.2024, vlerësohet të pezullohet vendimmarrja e bordit mbi aplikimin e shoqërisë për rinovimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali i përpunimit të mbetjeve urbane, Qarku Elbasan, me kapacitet të instaluar 2850 pasi shoqëria duhet që të depozitojë në ERE dokumentacionin, kontratën e rinovuar të qirasë me AAPSK brenda afatit të fundit të vlefshmërisë së saj, pra brenda datës 27.03.2024. Në nenin 14, pika 10, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, parashikohet se bordi i ERE rast pas rasti, pas fillimit të procedurës, mund të vendosë të pezullojë vendimmarrjen e tij.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të pezullojë vendimmarrjen për aplikimin e shoqërisë “ECO- ELB” sh.a., për rinovimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali i përpunimit të mbetjeve urbane, Qarku Elbasan, me kapacitet të instaluar 2850 kW, derisa shoqëria të depozitojë në ERE dokumentacionin si më poshtë vijon:
 - Kontratën e rinovuar të qirasë me Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara për përdorimin e impiantit të incenerimit për prodhimin e energjisë elektrike brenda datës 27.03.2024.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “ECO-ELB” sh.a. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI